



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 1152/17
Dt. 29.12.2017

PLANI I PUNËS PËR VITIN FISKAL
2018

VUSHTRRI / Dhjetor 2017

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 70 dhe 82 të Statutit të Komunës, me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Ligji për Prokurim Publik në Kosovë) si dhe vendimeve e konkluzioneve të kuvendit të komunës, Drejtoria Komunale për Prokurim më dt. 29.12.2017, Ju prezanton :

PLANIN E PUNËS TË DREJTORISË KOMUNALE PËR PROKURIM PUBLIK PËR VITIN FISKAL 2018

Drejtorja Komunale për Prokurim Publik e Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Planin e Punës për vitin fiskal 2018 dhe aktivitetin e saj të punës e mbështet në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, i shpallur me dekretin Nr. DL-041-2015, datë 29.12.2015(në tekstin e mëtejme LPP-së), Rregulloret, aktet dhe vendimet tjera të aprovuara nga Agjencioni Qendror i Prokurimit Publik (në tekstin e mëtejme AQP-së), Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik(në tekstin e mëtejme KRRPP-së) si dhe vendimeve dhe akteve tjera të organeve komunale, Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë e Financa dhe organeve tjera relevante.

Me këtë Plan identifikohen në detaje të arsyeshme të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë planifikon t'i realizoi gjatë vitit fiskal 2018, për gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

Sipas nenit 8 paragrafi 1 të LPP-së jo më pak se 30 ditë kalendarike para fillimit të viti fiskal 2018, secili Autoritet Kontraktues duhet të përgatis Planifikimin Paraprak të Prokurimit, në të cilin do duhej të identifikoheshin në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi gjatë vitit fiskal në fjalë, ndërsa sipas nenit 8 paragrafi 2 të LPP-së Brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, Autoriteti Kontraktues do të përgadisë dhe do të dorëzoj Agjencionit Qendrorë të Prokurimeve (AQP-së) një planifikim përfundimtarë me shkrim, i cili identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, punët dhe shërbimet që që Autoriteti Kontraktues parasheh ti prokuroi gjatë viti fiskal në fjalë.

Meqenëse Plani është ngushtë i lidhur me përgatitjen e buxhetit komunal për vitin fiskal 2018 si dhe me aktivitetin gjegjësisht planin e punës të drejtorisë , Plani në përgjithësi do duhej të jetë i harmonizuar dhe të korrespondoj me kufijtë e buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin fiskal 2018, për të gjitha shtyllat e buxhetit, si vijon :

- Administratë
- Shëndetësi
- Arsim
- Zyra Lokale e Komuniteteve
- Njësia e Zjarrfikësve
- Shtëpia rezidenciale në Lum Madh

Po ashtu, në pajtim me dispozitat e nenit 39 të LPP-së, Drejtoria Komunale për Prokurim do të përgadis dhe dërgoi për publikim në KRPP edhe Njoftimin Paraprak. Ky Njoftim publikohet kur një Autoritet Kontraktues ka për qëllim dhënie, gjatë periudhës së ardhëshme 12 mujore, të një ose më shumë kontratave të furnizimeve, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose së bashku, kanë një vlerë të parashikuar prej pesëqindmijë (500,000.00 €).

Njoftimi Paraprak, në pajtim me dispozitat e nenit 39 paragrafi 2 të LPP-së duhet të përgatitet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, dhe Autoriteti Kontraktues do të siguroi se gjitha verzionet e gjuhëve të një njoftimi paraprak janë në pajtueshmëri me ligjin dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

Përmes këtij Njoftim, veç KRPP-së dhe AQP-së, informacione të sakta për synimet e aktiviteteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues, mundë të sigurojnë edhe Operatorët Ekonomik të interesuar.

Planifikimi përfundimtarë, si dokument i aprovuar nga organi kompetent i Autoritetit Kontraktues do duhej të ishte pjesë përbërëse e Planit të punës të Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik.

Në vazhdim po paraqesim në detaje të arësyeshme planifikimin – objektivat e Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik të cilat Drejtoria synon t'i realizoi gjatë vitit fiskal 2018, sipas kategorive, punë, shërbime dhe furnizime, për t'i përmbushur kërkesat gjegjësisht planifikimet e gjitha shtyllave buxhetore – njësisive shpenzuese të Autoritetit Kontraktues, si vijon :

KONTRATAT PËR FURNIZIM

Nr.	Përshkrimi i furnizimeve	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e fillimit	Bartës të aktivitetit (Njësia kërkuese)
1	Furnizim me materjal zyrtar	80.270,00 €	2018	gjitha drejtoritë
2	Furnizimi me naft dhe derivate të naftës	140.707,00 €	2018	Administrata, Shërbimet Publike, QKMF, Kultura, Arsimi, zjarrfikësat
3	Furnizim me materiale të shtypura për zyre	6,300.00	2018	Gjitha drejtoritë
4	Furnizimi me orendi për zyre	12,514.00	2018	Gjitha drejtoritë
5	Furnizimi me pajisje tjera	15,884.00	2018	Gjitha drejtoritë
6	Furnizimi me veshmbathje	19,800.00	2018	Zyra e kryetarit, shërbimet publike, inspekcioni, DBTHF, zjarrfikësat
7	Furnizimi me ushqim dhe pije	63,200.00	2018	Zyra e kryetarit, shëndetësia, kultura, zjarrfikësat, arsimi, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
8	Furnizimi me material higjenik	44,906.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimi, kultura,

				zjarrfikësat, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
9	Furnizimi me material për mirëmbajtje të objekteve të AK	20,131.00	2018	Administrata, arsimi, shëndetësia, shtëpia rezidenciale në Lum Madh, zjarrfikësat
10	Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje të teknologjisë informative	25,293.00	2018	Zyra e kryetarit, kryesuesit të K.K.-së, shërbimet publike, administrata, shtëpia rezidenciale në Lum Madh, arsimi,
11	Furnizimi me dru për ngrohje	77,500.00	2018	Arsimi, shëndetësia
12	Furnizimi me thëngjill për ngrohje	54,800.00	2018	Arsimi
13	Furnizimi me aparate fotokopjuese	3,410.00	2018	Arsimi, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
14	Furnizimi me inventar për shkolla	30,000.00	2018	arsimi
15	Furnizimi me inventar për objektin e ri të komunës	35,000.00	2018	administrata
16	Furnizimi me medikamente dhe material shpenzues medicinal për QKMF-re	38,307.00	2018	QKMF-re
17	Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të sistemit për menaxhimin e rendit	20,000.00	2018	QKMF-re
18	Furnizimi me pajisje speciale mjeksore	1,380.00	2018	shtëpia rezidenciale në Lum Madh
19	Furnizimi me aparatur dhe mjete pune për QKMF-re	21,600.00	2018	QKMF-re
20	Furnizim me inventar për QKMF	5,000.00	2018	QKMF-re
21	Furnizimi me automjetë(Autoambulancë)	80,000.00	2018	QKMF-re
22	Furnizimi me automjetë tereni me 5 ulëse dhe rimorkio	28,000.00	2018	QKMF-re

23	Furnizimi dhe vendosja e kamerave në qytet	10,000.00	2018	Shërbimet publike
24	Furnizimi me gypa për kanalizime të ujrave të zeza	40,000.00	2018	Shërbimet publike
25	Furnizimi me kontejnerë për mbeturina	25,000.00	2018	Shërbimet publike
26	Furnizim me pajisje për zjarrfikës	4,100.00	2018	Njësia e zjarrfikësve
27	Furnizimi me libra për bibliotekë	25,000.00	2018	kultura
28	Furnizimi me paisje për muazeun e qytetit	16,000.00	2018	kultura
29	Furnizimi me paisje për muazeun- zyren e turizmit	15,000.00	2018	kultura
30	Furnizimi me pajisje laboratorike për shkolla	25,000.00	2018	arsimi
31	Furnizimi me pajisje për shkolla	29,261.00	2018	arsimi
32	Furnizim me pajisje për qendren rinore	20,000.00	2018	kultura
33	Furnizimi me makina për nxerrjen e patateve	15,000.00	2018	Ekonomi-Bujqësi
34	Furnizimi me makina për nxerrjen e qepëve	15,000.00	2018	Ekonomi-Bujqësi
35	Furnizimi me makina për konzervimin e barit (rrotoballer)	30,000.00	2018	Ekonomi-Bujqësi
36	Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik	30,000.00	2018	Ekonomi-Bujqësi
37	Furnizim me preparatete kimike	1,100.00	2018	arsimi
	Totali:	1.124.463,00€		

KONTRATAT PËR SHERBIME

Nr. Rendor i prokuri meve	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Bartës të aktivitetit
1	Servisimi i teknologjisë informative	5,350.00	2018	Gjitha drejtoritë
2	Botimet e reklamave dhe konkurëseve	6,450.00	2018	Zyra e kryetarit, administrate, arsimit, shëndetësia
3	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	42,200.00	2018	Shërbimet publike, shëndetësia, zjarrfikësat, arsimit, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
4	Shërbimet e internetit	3,470.00	2018	arsimi
5	Shërbimet hoteliere	14,810.00	2018	Zyra e kryetarit, kryesuesi i KK-së, administrate, arsimit
6	Sigurimi fizik i objekteve komunale, shkollave, QPS-le dhe QKMF-re	288,000.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimit
7	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të AK-Vushtrri	182,400.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimit
8	Transporti i nxënësve	139,995.00	2018	arsimi
9	Pastrimi dhe larja e rrugëve të qytetit	72,000.00	2018	Shërbimet publike
10	Shërbime tjera kontraktuese	235,559.00	2018	Gjitha drejtoritë
11	Menaxhimi i mbeturinave	622,089.00	2018	Shërbimet publike
12	Shërbimet e udhimit jashtë vendit	13,200.00	2018	Zyra e kryetarit dhe drejtori tjera
13	Shërbimet e ndryshme shëndetsore	8,100.00	2018	QKMF-re
14	kontrolli teknik i automjeteve	1,600.00	2018	Shërbimet publike

15	Hartimi i projekteve	100,000.00	2018	urbanizmi
16	Rrjeta gjeodezike	20,000.00	2018	kadastrri
17	Shtypja e materialeve të nevojshme për AK - Vushtrri	2,100.00	2018	Gjitha drejtoritë
18	Shërbimet e udhimit brenda vendit	1,000.00	2018	Administrata, arsimit
19	Mbulimi i normave të interesit për bizneset e reja	100,000.00	2018	Ekonomi – bujqësi
20	Mirëmbajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	17,720.00	2018	Gjitha drejtoritë
		1.876.043,00 €		

KONTRATAT PËR PUNË

Nr. Rendor i prokurimeve	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Bartës të aktivitetit
1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Novolan (dy vjeçar)	43,500.00	2018	urbanizmi
2	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Smrekonicë (dy vjeçar)	36,400.00	2018	urbanizmi
3	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Beqok	25,200.00	2018	urbanizmi
4	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Galicë (dy vjeçar)	38,220.00	2018	urbanizmi
5	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bruznik (dy vjeçar)	66,700.00	2018	urbanizmi
6	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Maxhunaj (tre vjeçar)	114,520.00	2018	urbanizmi
7	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Samadrexhë	27,720.00	2018	urbanizmi
8	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Reznik (lagja Mustaf, Curri dhe Makiqi) dhe në fshatin Shallc (tre vjeçar)	124,740.00	2018	urbanizmi
9	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Sllakoc (tre vjeçar)	303,940.00	2018	urbanizmi
10	Asfaltimi i rrugës Vushtrri -Nadakoc-Pestovë (tre vjeçar)	1,188,980.00	2018	urbanizmi
11	Asfaltimi i rrugës Sllatinë-Tërllabuq (dy vjeçar)	56,000.00	2018	urbanizmi
12	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pantinë (dy vjeçar)	75,600.00	2018	urbanizmi

13	Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lum Madh-Prelluzhë-Gracë (dy vjeçar)	150,000.00	2018	urbanizmi
14	Asfaltimi i rrugëve lokale në tri Dumnicat (tre vjeçar)	128,260.00	2018	urbanizmi
15	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ropicë	10,500.00	2018	urbanizmi
16	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ceceli (dy vjeçar)	235,020.00	2018	urbanizmi
17	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Studime e Epërme (dy vjeçar)	31,000.00	2018	urbanizmi
18	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Studime e Poshtme (dy vjeçar)	29,400.00	2018	urbanizmi
19	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Sfaraqak (dy vjeçar)	61,600.00	2018	urbanizmi
20	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Akrashticë (tre vjeçar)	74,340.00	2018	urbanizmi
21	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pestovë	16,422.00	2018	urbanizmi
22	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Banjskë (dy vjeçar)	40,000.00	2018	urbanizmi
23	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Dobërllukë (tre vjeçar)	91,520.00	2018	urbanizmi
24	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bukosh	21,000.00	2018	urbanizmi
25	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Vërnice	10,500.00	2018	urbanizmi
26	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Duboc (dy vjeçar)	27,720.00	2018	urbanizmi
27	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Beçiq (dy vjeçar)	24,360.00	2018	urbanizmi
28	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Shallc (dy vjeçar)	23,100.00	2018	urbanizmi
29	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pasomë (dy vjeçar)	21,420.00	2018	urbanizmi
30	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ashlan (dy vjeçar)	42,000.00	2018	urbanizmi
31	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Mihaliq (dy vjeçar)	59,640.00	2018	urbanizmi
32	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Stroc	10,920.00	2018	urbanizmi
33	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bivolak (dy vjeçar)	16,800.00	2018	urbanizmi
34	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Balincë	42,000.00	2018	urbanizmi

35	Rrugët e rendit të katërt	80,000.00	2018	Shërbimet publike
36	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni	161,779.00	2018	Shërbimet publike
37	Ndërtimi i trotuareve	80,000.00	2018	Shërbimet publike
38	Ndërtimi i kanalizimeve	262,000.00	2018	Shërbimet publike
39	Ndriçimi Publik	20,000.00	2018	Shërbimet publike
40	Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara	166,364.00	2018	Shërbimet publike
41	Projektet në bashkëfinancim me donator	100,000.00	2018	Shërbimet publike
42	Ndërtimi i parqeve	20,000.00	2018	Shërbimet publike
43	Ndërtimi i banesave për familjet e dëshmorëve, invalid të luftës së UÇK-së (tre vjeçar)	530,000.00	2018	Shërbimet publike
44	Ndërtimi i urës në fshatin Dobërllukë	20,000.00	2018	Shërbimet publike
45	Platoja dhe gjelbrimi te banesat e bardha (tre vjeçar)	315,000.00	2018	Shërbimet publike
46	Ndërtimi i Impiantit (tre vjeçar)	350,000.00	2018	Shërbimet publike
47	Ndërtimi i shtratit të lumit "Podrança me infrastruktur Sllatinë (tre vjeçar)	491,769.00	2018	Shërbimet publike
48	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	40,000.00	2018	Shërbimet publike
49	Ndërtimi i lapidarit për martirët e luftës së dytë botërore dhe luftës së UÇK-së	15,000.00	2018	Shërbimet publike
50	Rregullimi i shtratit të Lumit "Silnica" (tre vjeçar)	625,556.00	2018	Shërbimet publike
51	Ndërtimi i fushave sportive	26,000.00	2018	arsimi
52	Meremetimi (Renovimi) i shkollave	100,000.00	2018	Arsimi
53	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatinë Stanoc i Epërm (tre vjeçar)	300,000.00	2018	Arsimi
54	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatinë Beçuk	87,405.00	2018	Arsimi
55	Ndërtimi i puntorisë dhe kabineteve në shkollën e mesme teknike	20,000.00	2018	Arsimi
56	Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve qendrore me pelet	67,000.00	2018	shëndetësia
57	Renovimi dhe adaptimi i dy zyreve	3,000.00	2018	shëndetësia
58	Ndërtimi i aneksit të qendrës rezidenciale	10,000.00	2018	Qendra rezidenciale Lum Madh
59	Renovimi i stadiumit të Hendbollit "Musa Abazi"	30,000.00	2018	Kultura

60	Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit	30,000.00	2018	Kultura
61	Renovimi i stadiumit të futbollit (dy vjeçar)	60,000.00	2018	Kultura
62	Ndërtimi I kullës së UÇK-së në fshatinë Zhilivodë (dy vjeçar)	40,000.00	2018	Kultura
63	Rregullimi i kulmit, ngrohëjes qendrore dhe ventilimi të palestrës së sporteve (dy vjeçar)	120,000.00	2018	Kultura
64	Rregullimi I lumenjeve dhe argjinaturave	20,000.00	2018	Ekonomi-bujqësi
65	Projektet me bashkfinancim me donatorë (bujqësi)	50,000.00	2018	Ekonomi-bujqësi
66	Rregullimi i varrezave	15,000.00	2018	Shërbimet publike
67	Ndërtimi i lapidarëve	30,000.00	2018	Shërbimet publike
		7.554.915,00€		

KONKURSI PROJEKTIMIT

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e fillimit	Bartës të aktivitetit
1	Harta zonale	100.000,00 €	2018	Drejtoria e Urbanizmit
		100.000,00€		

Ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e LPP-së, asnjë informatë mbi aktivitetet e planifikuara të prokurimit të Autoritetit Kontraktues nuk duhen të bëhen publike apo t'i zbulohen dikujt para publikimit të njoftimeve standarde. Arsyeja për këtë është mbrojtja e parimit të trajtimit të barabartë, i cili në këtë moment donë të thotë se informatat mbi një aktivitet të veçantë të prokurimit do t'i zbulohet operatorëve ekonomik në të njëjtën kohë.

Me gjithë obligimin sikurse u theksua më lartë, Drejtoria për Prokurim siguron se të gjitha iniciimet e procedurave të aktivitetit të prokurimit do të zbatohen dhe kryhen sipas LPP-së, neni 33, 34, 35 dhe 36, kapitulli mbi Rregullat mbi reklamimin dhe transparencën, në afat të caktuar kohorë, duke siguruar konkurrencë të drejtë, shfrytëzim sa më të mirë të parasë publike, efikasitet dhe ekonomizim në zbatimin e drejtë të procedurave të prokurimit, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik.

Një nga detyrat permanente të Drejtorisë do të jetë transparenca në zbatimin e gjitha proceduarve sipas LPP-së, duke filluar nga:

- Proceduar e hapur dhe e kufizuar
- Procedura konkurruese me negociata
- Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës
- Procedura Konkursi i projektimit
- Procedura e kuotimit të çmimeve, dhe
- Procedura e prokurimit në vlera minimale.

Varësisht nga aplikimi i cilësdo nga këto procedura, në rastet kur kjo parashihet me Ligj, Drejtoria do të zbatoi dispozitat ligjore, konform LPP-së.

Secili process i prokurimit do të administrohet perms 8 hapave, si në vijim :

Hapi 1	Planifikimi i Prokurimit
Hapi 2	Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës
Hapi 3	Përcaktimi i Vlerës së Prokurimit
Hapi 4	Përgatitja e Dosjes së Tenderit
Hapi 5	Publkimi
Hapi 6	Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve
Hapi 7	Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës
Hapi 8	Menaxhimi i Kontratës

Edhe gjatë viti fiskal 2018 detyrë parësore e Drejtorisë do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkesave të njërive shpenzuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit, si dhe përgatitja e planifikimit preliminar për gjitha llojet e prokurimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2019. Ky Plan, sikurse u theksua më lartë, duhet ti prezantohet- dërgohet AQP-së 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal.

Për iniciimin e aktivitetit të proceduarve të prokurimit, Drejtoria, në harmoni me dispozitat e LPP-së, do të zhvilloi procedurën, si vijon:

- Vlerësimi i nevojave dhe disponshmëria e mjeteve nga Zyrtari Kryesorë Administrativ , sipas nenit 9 i LPP-së ;
- Llogaritja e vlerës(para llogaria) dhe klasifikimi i kontratës, sipas nenit 16, 17 dhe 18 të LPP-së ;
- Përcaktimi i procedurës së prokurimit sipas nenit 19 të LPP-së ;
- Përgatitja e dosjes së tenderit, sipas nenit 27 të LPP-së ;
- Dërgimi për publikim në Platformën elektronike i njoftimit për kontratë sipas nenit 40 të LPP-së ;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderit sipas neni 58 dhe 59 të LPP-së ;
- Njoftimi me shkrim i KRPP-së dhe Op. Ek. mbi rezultatet e vendosjes për përzgjedhje e operatorit Ekonomik të suksesshëm;
- Kërkesat për Rishqyrtim dhe Ankesat eventuale nga Op. Ek. pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit dhe procedimi lidhur me të njëjtat;
- Nënshkrimi dhe përkujdesja lidhur me zbatimin efektiv të kontratës sipas nenit 26 të LPP-së.

Për të pasur një efikasitet sa më të lartë në zbatimin e detyrave të punës si dhe për ti përmbushur objektivat e saja të punës, Drejtoria për Prokurim, në planin e vet të punës, edhe për vitin 2018, ashtu sikurse parashohin edhe dispozitat e nenit 25 të LPP-së, parasheh trajnimin dhe perfeksionimin e mëtejme të personelit, si trajnime të organizuara dhe të obliguara nga KRPP në bashkëpunim me IKAP-in (Instituti Kosovar i Administrimit Publik) ashtu edhe trajnime për zbatimin e teknologjisë informative.

Për informimin e Juaj ju bëjmë me dije se që nga 1 janari i viti 2017, me vendim të KRPP-së, përdorimi i prokurimit elektronik është bërë i obligueshëm për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror, local dhe ndërmarrjeve publike.

Në nivelin local, Prokurimi elektronik zbatohet për prokurimet në vlera të mesme dhe të mëdha.

Drejtorja për prokurim, në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësisë të saj që i ka në bazë të ligjit, udhëzimeve administrative nga KRPP-ja dhe akteve normative komunale do të përgatitë dhe prezantoi për shqyrtim pranë organeve kompetente, si atyre qendrore dhe atyre komunale, raporte mbi prokurimet për periudhën gjashtëmujore dhe përfundimtare-vjetore ,për gjitha shtyllat e buxhetit.

Gjithashtu, në fushën e vetë të përgjegjësisë, Drejtoria për Prokurim, personeli i sajë, do të marrë pjesë, do të kontribuoj dhe implementoi vendimet e Kuvendit Komunal dhe komisioneve të tij, Komitetit për Politikë e Financa, do ti raportoj rregullisht Kryetarit të Komunës për çështjet që janë nën përgjegjësinë e drejtorisë, duke i ofruar atij informatat dhe raportet e nevojshme lidhur me ecurinë e punës në drejtori dhe për procesin e vendimmarrjes. Kujdes të vazhdueshëm do ti kushtohet edhe implementimit të kontratave të lidhura në vitin 2017 e të cilat sipas planifikimit dhe planit dinamik duhen të përfundohen në vitet vijuese, 2018 ose 2019, me thks të veçantë kontratat e punës. Në këtë drejtim duhet të ekzstoj një bashkëpunim shumë i ngushtë me drejtorinë komunale inicuese të aktivitetve të tilla, me thks të veçantë me Drejtorinë Komunale për Buxhet Thesar e Financa për të evidentuar dhe siguruar shumat e mjeteve financiare për përmbushjen me sukses dhe në kohë të kontratave.

Një bashkëpunim të ngushtë Drejtoria do ta ketë edhe me AQP-n për të ofruar informata të nevojshme për te, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjn e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autorriteteve kontraktuese të nivelit local ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së.

Drejtorja do të bashkëpunoi ngusht edhe me USAID-in dhe organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e Marrëveshjes së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Vushtrisë dhe USAID-it, e cila në focus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës në Komunën e Vushtrisë, me theks të veçantë trajnimin e stafit për kryerjen me sukses të aktivitetetve të punës, hapje tenderëve, vlerësim dhe menaxhim të kontratave dhe punë tjera të nevojshme.

Drejtorja komunale për prokurim Publik
D r e j t o r i,

Saranda Cakaj